REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 315, Datë 26.10.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E "RREGULLORES PËR PROCEDURAT E HEQJES SË LICENCAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 16, 42, pika 1, dhe 45 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", si dhe të nenit 15 të "*Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*", miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2026, pasi shqyrtoi relacionin nr. 3181 prot., datë 26.10.2026 të përgatitur nga Grupi i Punës "*Mbi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin dhe miratimin e "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike*",

Konstatoi se:

- Në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të ERE-s nr. 137, datë 18.08.2026, është ngritur Grupi i Punës për hartimin dhe rishikimin e akteve rregullatore që lidhen me licencimin dhe ushtrimin e veprimtarive të licencuara, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike". Në përmbushje të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, Grupi i Punës ka hartuar projekt-rregulloren "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike".
- Në mbështetje të neneve 16, 42, pika 1, dhe 45 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", ERE është autoriteti përgjegjës për licencimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, si dhe për vendimmarrjen lidhur me heqjen e licencave, në rastet dhe sipas kushteve të përcaktuara në ligj. Në ushtrim të këtyre kompetencave, ERE miraton aktet rregullatore që përcaktojnë procedurat për heqjen e licencave, duke përfshirë edhe trajtimin e masave të përkohshme për garantimin e vazhdimësisë së furnizimit me energji elektrike, sipas parashikimeve të nenit 45 të ligjit.
- Rregullorja për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, është hartuar në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror". Miratimi i ligjit nr. 59/2026 ka bërë të nevojshëm rishikimin e kuadrit rregullator ekzistues për pjesën që lidhet me sektorin e energjisë elektrike, me qëllim përshtatjen e procedurave të heqjes së licencave me dispozitat e ligjit të ri.
- Projekt-rregullorja e hartuar përmban 14 nene dhe përcakton procedurat për konstatimin e rrethanave që mund të çojnë në heqjen e licencës, fillimin dhe zhvillimin e procedurës administrative, njoftimin e të licencuarit, garantimin e së drejtës për t'u dëgjuar, administrimin dhe shqyrtimin e provave, si dhe përgatitjen e relacionit përfundimtar për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s. Gjithashtu, projekt-rregullorja parashikon elementet kryesore të vendimit për heqjen e licencës, detyrimet që vijojnë pas heqjes së saj dhe trajtimin e masave të përkohshme, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 59/2026.

- Përpara miratimit përfundimtar, projekt-rregullorja do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE-s dhe do t'i nënshtrohet procesit të konsultimit me palët e interesuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e ERE-s për miratimin e akteve rregullatore. Grupi i Punës do të administrojë dhe shqyrtojë komentet dhe propozimet e paraqitura gjatë konsultimit, duke vlerësuar përfshirjen e tyre në projekt-rregullore dhe duke pasqyruar rezultatet e këtij procesi në relacionin përfundimtar që do t'i paraqitet bordit të ERE-s, së bashku me projekt-rregulloren e rishikuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për shqyrtimin dhe miratimin e "*Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike"*, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Projekt-rregullorja t'i nënshtrohet procesit të publikimit dhe konsultimit me palët e interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga ERE për miratimin e akteve rregullatore.
3. Ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 137, datë 18.08.2026, për ndjekjen e procedurës administrative, publikimin e projekt-rregullores, zhvillimin e konsultimit me palët e interesuara, administrimin dhe shqyrtimin e komenteve dhe propozimeve të paraqitura, si dhe përgatitjen e relacionit përfundimtar dhe të projekt-rregullores së rishikuar për shqyrtim nga bordi i ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s rishikimin e vendimit brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, në rast se ka siguruar prova të reja që mund të çojnë në marrjen e një vendimi të ndryshëm ose në rast të gabimeve materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

Miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s Nr. 315, Datë 26.10.2026

Projekt-RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E HEQJES SË LICENCAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 1
Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të ligjit nr. 59/2026, "*Për sektorin e energjisë elektrike*", nenet 16, 19, 42, pika 1, dhe 45, si dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedura të qarta, transparente, të paanshme dhe jodiskriminuese për shqyrtimin dhe vendimmarrjen e Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, duke garantuar respektimin e të drejtave procedurale të të licencuarve dhe mbrojtjen e interesit publik.

2. Procedurat zbatohen në mënyrë proporcionale, duke marrë në konsideratë natyrën dhe rëndësinë e shkeljes, rrezikun për sigurinë e furnizimit, ndikimin mbi klientët dhe mundësinë e korrigjimit të shkeljes, kur korrigjimi lejohet nga ligji.

Neni 3
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton rastet dhe hapat proceduralë për fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e procedurës për heqjen e licencës së dhënë nga ERE për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike.

2. Rregullorja zbatohet për të licencuarit në veprimtaritë e parashikuara nga ligji nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike".

3. Masat e përkohshme të parashikuara në këtë rregullore zbatohen vetëm në kushtet dhe kufijtë e përcaktuar në nenin 45 të ligjit nr. 59/2026.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ligji" është ligji nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike".

2. "ERE" është Enti Rregullator i Energjisë.

3. "Bordi" është organi vendimmarrës i ERE-s.

4. "I licencuar" është personi fizik ose juridik, i pajisur me licencë për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike.

5. "Heqja e licencës" është vendimmarrja e ERE-s për përfundimin e së drejtës së të licencuarit për të ushtruar veprimtarinë e përcaktuar në licencë, në rastet dhe sipas procedurës së parashikuar nga ligji.

6. "Masë e përkohshme" është masa e parashikuar në nenin 45 të ligjit, e cila synon vazhdimësinë e veprimtarisë dhe përdorimin e aseteve kur kjo është e nevojshme për sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin që u jepet në ligjin nr. 59/2026 dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Rastet e heqjes së licencës

1. Në përputhje me nenin 45, pika 1, të ligjit, ERE heq licencën kur i licencuari:
   a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë sipas ligjit;
   b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë;
   c) rrezikon shëndetin, jetën ose pronën e njerëzve;
   d) nuk kryen pagesat rregullatore të vendosura nga ERE-ja, sipas nenit 17 të ligjit;
   e) bëhet financiarisht i paaftë ose kërkon shpalljen e falimentimit;
   f) kërkon revokimin e licencës;
   g) pushon së kryeri funksionet e specifikuara në licencë.

2. Konstatimi i një rrethane të mësipërme do të mbështetet në fakte dhe dokumente të administruara në dosjen administrative, përfshirë, sipas rastit, dokumente, akte ose informacione të lëshuara apo të përcjella nga organet dhe institucionet kompetente, në përputhje me fushën e tyre të përgjegjësisë.

3. Në vlerësimin e rastit, ERE-ja merr në konsideratë natyrën e shkeljes, kohëzgjatjen, përsëritjen, pasojat, rrezikun aktual ose të pritshëm dhe çdo masë korrigjuese të ndërmarrë nga i licencuari, pa cenuar rastet kur ligji kërkon heqjen e licencës.

Neni 6

Konstatimi i rrethanave dhe fillimi i procedurës

1. Procedura mund të nisë kryesisht nga ERE, mbi bazën e të dhënave të administruara nga strukturat përgjegjëse, rezultatet e mbikqyrjes periodike, monitorimi, raportet të institucioneve kompetente, informacionit të operatorëve ose të palëve të treta, si dhe në bazë të kërkesës së të licencuarit për heqjen e licencës.

2. Struktura përgjegjëse e ERE-s verifikon informacionin fillestar dhe përgatit një relacion për Bordin, ku përshkruhen faktet e konstatuara, dispozitat ligjore dhe kushtet e licencës që mund të jenë shkelur, provat mbështetëse dhe propozimi për fillimin ose mosfillimin e procedurës.

3. Bordi vendos për fillimin e procedurës me vendim të arsyetuar.

4. Kur kërkesa për heqjen e licencës paraqitet nga vetë i licencuari, struktura përgjegjëse verifikon identitetin dhe kompetencën e përfaqësuesit, licencën përkatëse, kërkesën e shprehur qartë dhe çështjet që duhet të trajtohen për mbylljen e rregullt të veprimtarisë.

Neni 7

Njoftimi i të licencuarit dhe e drejta për t'u dëgjuar

1. Pas vendimit për fillimin e procedurës, ERE njofton me shkrim të licencuarin, duke i vënë në dispozicion vendimin dhe arsyet e fillimit të procedurës, faktet dhe provat kryesore, dispozitat përkatëse dhe pasojat e mundshme.

2. I licencuari ka të drejtë të paraqesë shpjegime, kundërshtime dhe prova me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.

3. Me kërkesë të arsyetuar, ERE- mund të vlerësojë zgjatjen e afatit, nëse kjo nuk bie ndesh me ligjin dhe nuk cenon interesin publik ose të drejtat e palëve të tjera.

4. I licencuari ka të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes administrative dhe të paraqesë kërkesa për marrjen e provave, në përputhje me legjislacionin për procedurat administrative dhe me kufizimet ligjore për informacionin konfidencial.

5. Kur rrethanat e çështjes e kërkojnë, ERE mund të organizojë seancë dëgjimore ose të kërkojë sqarime shtesë. Mospërdorimi i së drejtës për të paraqitur shpjegime brenda afatit nuk e pengon ERE-n të vijojë procedurën mbi bazën e akteve të administruara.

Neni 8

Shqyrtimi i provave dhe relacioni përfundimtar

1. Struktura përgjegjëse shqyrton shpjegimet dhe provat e paraqitura nga i licencuari, verifikon pretendimet që kanë rëndësi për çështjen dhe dokumenton veprimet e kryera në dosjen administrative.

2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes së të licencuarit ose nga përfundimi i afatit për paraqitjen e saj, struktura përgjegjëse përgatit relacionin përfundimtar për Bordin. Kur çështja kërkon verifikime shtesë, afati mund të zgjatet me arsyetim të dokumentuar, në përputhje me legjislacionin për procedurat administrative.

3. Relacioni përfundimtar përmban të paktën: përmbledhjen e procedurës; faktet dhe provat; qëndrimin e të licencuarit; analizën e pretendimeve; vlerësimin e përmbushjes së kushteve ligjore për heqjen e licencës; ndikimin e mundshëm te klientët dhe siguria e furnizimit; si dhe propozimin e arsyetuar për përfundimin e procedurës, heqjen e licencës ose marrjen e masave të tjera që lejohen shprehimisht nga ligji.

4. Nëse provat nuk mbështesin shkakun e heqjes së licencës, i propozohet Bordit mbyllja e procedurës. Nëse shkelja është e korrigjueshme dhe ligji e lejon, relacioni mund të propozojë një afat të arsyeshëm për korrigjimin e saj.

5.

Neni 9

Vendimmarrja e Bordit

1. Bordi, pasi shqyrton dosjen administrative dhe relacionin përfundimtar, vendos me vendim të arsyetuar:
   a) mbylljen e procedurës, kur nuk provohen kushtet ligjore për heqjen e licencës;
   b) caktimin e një afati për korrigjimin e shkeljes, kur kjo është e mundur dhe e lejueshme sipas ligjit;
   c) heqjen e licencës, kur vërtetohen kushtet e nenit 45 të ligjit;
   d) për rastin e kërkesës së të licencuarit, heqjen e licencës dhe përcaktimin e veprimeve të nevojshme për përfundimin e rregullt të veprimtarisë, sipas ligjit dhe kushteve të licencës.

2. Vendimi duhet të identifikojë licencën dhe veprimtarinë përkatëse, bazën ligjore, faktet e provuara, vlerësimin e pretendimeve kryesore, arsyet e pranimit ose mospranimit të tyre, datën nga e cila prodhon efekt heqja e licencës dhe detyrimet që mbeten për t'u përmbushur nga i licencuari.

3. Bordi merr vendim brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga paraqitja e relacionit përfundimtar, kur dosja është e plotë dhe nuk nevojiten veprime të tjera hetimore.

4. Vendimi për heqjen e licencës nuk e çliron të licencuarin nga detyrimet financiare, kontraktore, administrative ose ligjore të lindura deri në datën efektive të heqjes së licencës.

Neni 10

Masat e përkohshme për garantimin e furnizimit

1. Kur hiqet licenca e një të licencuari që ushtron veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike ose furnizimit me energji elektrike dhe kur plotësohen kushtet e nenit 45, pika 2, të ligjit, ERE-ja vlerëson nevojën për vendosjen e një ose disa masave të përkohshme për të siguruar vazhdimësinë e furnizimit me energji elektrike të klientëve.

2. Në përputhje me nenin 45 të ligjit, masat mund të përfshijnë:
   a) vendosjen e shoqërisë nën administrim të kufizuar për një periudhë të caktuar;
   b) caktimin e një shoqërie tjetër që plotëson kushtet përkatëse të licencimit për kryerjen e veprimtarisë;
   c) emërimin e një administratori të përkohshëm, me propozimin e ministrit përgjegjës dhe në përputhje me procedurën e kriteret e miratuara nga Këshilli i Ministrave.

3. Në vendimin për masën e përkohshme, ERE-ja përcakton arsyet, objektin, kohëzgjatjen, kushtet e ushtrimit të veprimtarisë, detyrimet e subjektit, raportimin dhe mënyrën e monitorimit. Masa duhet të jetë e nevojshme dhe proporcionale me qëllimin e garantimit të furnizimit.

4. Masat e përkohshme zbatohen për një periudhë jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e heqjes së licencës dhe monitorohen nga ERE, sipas nenit 45 të ligjit.

Neni 11

Detyrimet gjatë dhe pas përfundimit të procedurës

1. I licencuari duhet të bashkëpunojë me ERE-n dhe të paraqesë informacionin e kërkuar në mënyrë të plotë, të saktë dhe brenda afateve të përcaktuara.

2. Gjatë procedurës, i licencuari vijon të përmbushë detyrimet që burojnë nga ligji, licenca dhe aktet rregullatore në fuqi, përveç rasteve kur një akt i organit kompetent parashikon ndryshe.

3. Heqja e licencës nuk shuan detyrimin për pagesat rregullatore të papaguara dhe detyrimet e tjera që kanë lindur gjatë periudhës së licencimit. ERE mund të ndjekë arkëtimin e detyrimeve sipas mekanizmave të parashikuar nga ligji.

4. Kur heqja e licencës mund të ndikojë në vazhdimësinë e shërbimit, të dhënat e matjes, shlyerjet, kontratat ose mbrojtjen e klientëve, ERE përcakton në vendim ose me akte të veçanta veprimet e nevojshme brenda kompetencave të saj.

Neni 12

Njoftimi dhe publikimi i vendimit

1. Vendimi i Bordit i njoftohet të licencuarit dhe palëve të tjera procedurale, kur ka të tilla, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e njoftimit të akteve administrative.

2. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të ERE-s dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Publikimi kryhet duke respektuar rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionit të mbrojtur me ligj.

3. Kur heqja e licencës përfshin një veprimtari të lidhur me detyrimin e shërbimit publik ose kërkon koordinim për sigurinë e furnizimit, ERE njofton institucionet dhe operatorët përkatës, sipas detyrimeve ligjore dhe nevojës për vazhdimësinë e shërbimit.

Neni 13

Rishikimi dhe ankimi

1. Kërkesat për korrigjimin e gabimeve materiale ose për rishikimin administrativ të vendimit shqyrtohen vetëm në rastet, kushtet dhe afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe nga rregullat e procedurës administrative të ERE-s.

2. Kundër vendimit të Bordit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente, në përputhje me ligjin nr. 59/2026. Afati dhe efektet e ankimit përcaktohen nga dispozitat ligjore të zbatueshme dhe shënohen në vendim.

3. Paraqitja e kërkesës për rishikim ose e ankimit nuk pezullon zbatimin e vendimit, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji ose kur vendos organi gjyqësor kompetent.

Neni 14

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

1. Procedurat e filluara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shqyrtohen sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr. 59/2026 dhe rregullave për zbatimin në kohë të akteve administrative.

2. Çështjet që nuk rregullohen shprehimisht nga kjo rregullore zgjidhen në përputhje me ligjin nr. 59/2026, Kodin e Procedurave Administrative dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

3. Kjo rregullore ndryshohet me vendim të Bordit të ERE-s.

4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, dispozitat e akteve të mëparshme të ERE-s për heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike shfuqizohet sipas përcaktimit të vendimit të Bordit për miratimin e kësaj rregulloreje.

5. Dispozitat e *Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror*, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, që lidhen me sektorin e gazit natyror, vazhdojnë të zbatohen për këtë sektor deri në miratimin e një akti të ri ose ndryshimin e tyre nga Bordi i ERE-s, për aq sa janë në përputhje me ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, dhe aktet e tjera në fuqi. Kjo rregullore nuk rregullon dhe nuk shfuqizon procedurat e heqjes së licencave në sektorin e gazit natyror.

6. Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.